

STAFI POLITIK / KABINETI I KRYEMINISTRIT

VILMA GURI

Znj. Guri Mban detyrën e Drejtores së Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë që prej shkurtit 2026.

Gjatë vitit 2025, ajo shërbeu si Këshilltare e Kryeministrit për Administratën Publike dhe Drejtore e Departamentit të Administratës Publike (DAP), ku kontribuoi në hartimin dhe zbatimin e reformave të administratës publike, forcimin e qeverisjes së mirë, rritjen e efikasitetit institucional dhe përafrimin e praktikave administrative me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Nga viti 2009 deri në dhjetor 2024, znj. Guri përfaqësoi Programin e Kontrollit të Eksporteve dhe Sigurisë Kufitare (EXBS) të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me përgjegjësi për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë cilësi, ajo drejtoi dhe koordinoi nisma strategjike për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve kombëtare e rajonale në fushën e kontroleve të eksporteve strategjike, mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zbatimit të regjimeve ndërkombëtare të sanksioneve, monitorimit të investimeve të huaja direkte (FDI) dhe luftës kundër financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Përgjatë kësaj periudhe, ajo bashkëpunoi ngushtë me institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare dhe partnerë strategjikë për hartimin e politikave, forcimin e kuadrit rregullator dhe zhvillimin e mekanizmave ndërinstitucionalë që kontribuojnë në sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Znj. Guri është instruktore e certifikuar dhe e akredituar nga Instituti i Shërbimit të Jashtëm (Foreign Service Institute – FSI) i Departamentit të Shtetit të SHBA. Në këtë cilësi, ajo ka ofruar trajnime mbi leadershipin, menaxhimin dhe zhvillimin organizativ për zyrtarët e Shërbimit të Jashtëm amerikan të akredituar në ambasadat e SHBA në Evropë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive drejtuese dhe menaxheriale në mjedise diplomatike.

Më herët, nga viti 2002 deri në vitin 2009, ajo shërbeu si Asistente Programi pranë Programit Ndërkombëtar të Ndihmës për Trajnimin e Hetimeve Penale (ICITAP) të Departamentit të Drejtësisë të SHBA, duke mbështetur programe të asistencës teknike në fushën e sigurisë detare dhe aeroportuale.

Znj. Guri është e certifikuar nga Akademia e Kontrollit të Eksporteve e Universitetit të Xhorxhias (SHBA) dhe ka përfunduar një sërë programesh të avancuara të Institutit të Shërbimit të Jashtëm (FSI) të Departamentit të Shtetit të SHBA në fushat e leadershipit, menaxhimit, çështjeve politike, menaxhimit të programeve, monitorimit dhe vlerësimit.

Ajo zotëron diplomë Bachelor dhe Master në Studime të Gjuhës Angleze nga Universiteti i Tiranës.

Znj. Guri flet rrjedhshëm anglisht dhe italisht, si dhe ka njohuri të mira të gjuhës spanjolle dhe gjermane.

AJLA MAKSUTI

Ajla Maksuti mban detyrën e Drejtorit të Protokollit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë që prej qershorit 2025, ku drejton organizimin e veprimtarisë protokollare dhe koordinon angazhimet zyrtare e ceremoniale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Më herët, për pesë vite, ka shërbyer pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në Kryeministri, duke koordinuar aktivitete akademike, rinore dhe marrëdhëniet me publikun, me fokus në transparencën, qeverisjen e hapur dhe dialogun institucional.

Znj. Maksuti ka përfunduar studimet Master i Shkencave në Qeverisje Evropiane dhe Ndërkombëtare në Vrije Universiteit Brussel (VUB), në Belgjikë, me rezultate të larta (with Distinction), si dhe është diplomuar me rezultate të shkëlqyera (High Honors) në programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin Epoka.

Gjatë formimit të saj akademik, ajo është përfshirë në programe studimore dhe shkëmbime përvojë me institucionet kryesore të Bashkimit Evropian, përfshirë Parlamentin Evropian, Komisionin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian.

Ajo zotëron gjuhën angleze, italiane, franceze dhe spanjolle.

ALMA KANANI

Alma Kanani është Këshilltare Ekonomike e Kryeministrit të Shqipërisë. Në këtë pozicion, ajo drejton dhe koordinon punën e Kabinetit të Kryeministrit për të gjitha çështjet që lidhen me politikat ekonomike, zhvillimore dhe sociale të programit të qeverisjes, duke ofruar këshillim strategjik në hartimin dhe zbatimin e reformave kyçe.

Znj. Kanani vjen në këtë detyrë pas një karriere të gjatë dhe të spikatur prej 30 vjetësh në Bankën Botërore, institucion të cilit iu bashkua në vitin 1997 përmes një prej programeve më konkurruese të punësimit në nivel global, Programit të Profesionistëve të Rinj (Young Professionals Program) – një program që përzgjedh çdo vit një numër shumë të kufizuar profesionistësh të rinj nga e gjithë bota. Ajo ishte shqiptarja e parë që u punësua nëpërmjet këtij programi në historinë e Bankës Botërore.

Gjatë kësaj karriere të gjatë, ajo ka mbajtur pozicione të shumta teknike dhe drejtuese, duke punuar për vende dhe rajone të ndryshme në nivel global, përfshirë Evropën dhe Azinë Qendrore, Azinë Jugore, Amerikën Latine, si dhe Azinë Juglindore. Në këto role, znj. Kanani ka hartuar analiza ekonomike dhe ka udhëhequr projekte zhvillimi në mbështetje të vendeve anëtare të Bankës Botërore, në fusha të tilla si politika makroekonomike dhe fiskale, mirëqeverisja, si dhe menaxhimi i sektorit publik, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor.

Përveç pozicioneve teknike, znj. Kanani ka mbajtur edhe një sërë pozicionesh drejtuese të rëndësishme brenda Bankës Botërore, duke përfshirë drejtimin e Njesisë Globale për Mobilizimin e të Ardhurave Tatimore, si dhe drejtimin e Njesisë së Menaxhimit të Sektorit

Publik për një grup vendesh të Azisë Juglindore, ndër to Kina, Indonezia, Filipinet, Kamboxhia, Tajlanda, Malajzia, Mongolia, si dhe vendet e Ishujve të Paqësorit.

Përpara se t'i bashkohej Bankës Botërore, znj. Kanani e nisi karrierën e saj profesionale në Shqipëri, fillimisht si ekonomiste dhe më pas si Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit të Shtetit në Ministrinë e Financave. Në këtë rol, ajo pati mundësinë të kontribuonte drejtpërdrejt, për katër vite me radhë, në një nga transformimet më të mëdha dhe më sfiduese që ka njohur shteti shqiptar: kalimin nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu.

Në aspektin akademik, znj. Kanani ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, në degën Ekonomi, dhe më pas ka vijuar studimet pasuniversitare për Ekonomi në dy institucione prestigjioze ndërkombëtare: Universitetin e Londrës, në Mbretërinë e Bashkuar, dhe Universitetin e Kolumbias, në New York, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

MIRIAM SHYTI

Znj. Shyti është Këshilltare në Kabinetin e Kryeministrit të Shqipërisë.

Më parë, ajo ka shërbyer si Zëvendësministre e Evropës dhe Punëve të Jashtme, përgjegjëse për Diplomacinë Ekonomike, Kulturore, Digjitale dhe marrëdhëniet me Diasporën, ku krijoi iniciativë për forcimin e angazhimit të diasporës shqiptare, promovimin e diplomacisë ekonomike e kulturore dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e transformimit digjital.

Si Këshilltare në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka kontribuar në hartimin e rekomandimeve për politikën kulturore dhe rritjen e financimit të sektorit artistik; ka koordinuar programin e Javëve Kulturore Ndërkombëtare në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike në vend; ka konceptuar programin “Culturalb – Kultura Shqiptare Udhëton Botën”; si dhe ka koordinuar angazhimin e fondacionit francez Art Explora gjatë Samitit të Komunitetit Politik European në Tiranë, me rol kuratorial dhe koordinues.

Me një formim në Shkenca Komunikimi dhe Marrëdhënie Publike Politike, ajo ka ndjekur programe ndërkombëtare, përfshirë Edukimin Ekzekutiv mbi Menaxhimin e Inovacionit në Harvard Business School, Cambridge Institute for Sustainability Leadership, si edhe specializimin në Ekonominë e Tregut të Artit në Christie's Education.

Znj. Shyti është pjesë e programit ndërkombëtar Global Leadership for Sustainable Development si koordinatorë kombëtarë për Shqipërinë, duke promovuar lidhshëpin transformues dhe avancimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe vlerave.

Gjatë rrugëtimit të saj, ka mbajtur role kyçe në promovimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe në forcimin e bashkëpunimit me institucione, fondacione dhe organizata ndërkombëtare në fushën e kulturës, artit, diplomacisë publike dhe zhvillimit.

Znj. Shyti është anëtare e Bordit të Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura dhe ka qenë pjesë e Komitetit Drejtues të programit Evropa Krijuese. Ajo ka qenë përfituese e një burse shkëmbimi

profesional në Itali dhe gjithashtu në Los Angeles, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në fushën e artit dhe filantropisë, ku u angazhua në programe artistike dhe u bë pjesë e Association of Arts Administration Educators dhe New Art Dealers Alliance (NADA).

JONIDA SHEHU

Jonida Shehu është e angazhuar pranë Kryeministrit - Këshillit të Ministrave, ku kontribuon me përvojën e saj në fushën e komunikimit publik dhe informimit institucional.

Jonida Shehu është gazetare, autore dhe moderatore me 23 vjet karrierë në median audiovizive shqiptare. E diplomuar në degën Gazetari pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ajo e ka ndërtuar karrierën e saj mbi standardet e profesionalizmit, etikës dhe informimit të besueshëm.

Karrierën e nisi si gazetare terreni, duke mbuluar zhvillime me interes publik, dhe më pas drejtoi edicionet qendrore informative në disa prej mediave kryesore në vend. Gjatë karrierës së saj, ka qenë autore dhe moderatore e një sërë programesh të rëndësishme politike, informative dhe sociale, duke intervistuar personalitete të jetës politike, institucionale, ekonomike dhe publike.

Përveç angazhimit në media, Jonida Shehu ka ndjekur studime dhe trajnime të specializuara në fushën e komunikimit, etikës në media, trajtimit të çështjeve që lidhen me grupet vulnerabël dhe fotografisë, duke investuar vazhdimisht në zhvillimin e saj profesional.

ETILDA GJONAJ

Etilda Gjonaj (Saliu) ka lindur në Pukë më 6 maj 1981. Që prej muajit Nëntor 2025, ushtron detyrën e Këshilltares Ligjore të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe prej muajit Maj 2026 mban detyrën e anëtares së Komisionit të Venecias për Shqipërinë.

Znj. Gjonaj shërbeu si Ministre e Drejtësisë nga shtatori 2017 deri në shtator 2021, periudhë gjatë së cilës drejtoi zbatimin e Reformës në Drejtësi të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe, ushtroi gjithashtu funksionin e Koordinatorës Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe ishte një nga hartueset kryesore të angazhimit të Shqipërisë me Komisionin Europian në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24 të acquis-së së Bashkimit Europian.

Znj. Gjonaj u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë në Legjislaturën e X Pluraliste 2021–2025, ku shërbeu si Nënkryetare e Komisionit për Çështjet Europiane dhe anëtare e Komisionit për Politikën e Jashtme; Anëtare e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Shtetin e së Drejtës dhe Antikorrupsionin, në kuadër të axhendës së integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian deri në vitin 2030. Gjithashtu, shërbeu si Sekretare e Komisionit të Posaçëm për Luftën kundër Dezinformimit dhe Ndërhyrjeve të Huaja,

si dhe mbajti funksione në Byronë e Kuvendit, Këshillin për Legjislacionin dhe Këshillin Kombëtar për Integrimin Europian. Që nga viti 2022, znj. Gjonaj ishte Nënkryetare e Aleancës së Grave Deputete.

Përpara emërimit si Ministre e Drejtësisë, Znj. Gjonaj shërbeu si Zëvendësministre e Drejtësisë në vitin 2017, Eksperte pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi përgjatë viteve 2015–2017, si dhe Komisionere pranë Institucionit të Avokatit të Popullit në periudhën 2014–2017. Përpara angazhimit në funksione publike, ajo punoi për më shumë se njëmbëdhjetë vjet pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si juriste dhe aktiviste për të drejtat e njeriut, ku drejtoi programe në fushën e shtetit të së drejtës, drejtësisë penale, monitorimit të proceseve zgjedhore dhe zhvillimit të çështjeve strategjike gjyqësore. Ka patur angazhim gjatë kësaj periudhe me një sërë organizatash ndërkombëtare dhe vendase në ekspertiza të ndryshme dhe projekte në fushën e të drejtës.

Në nivel ndërkombëtar, Znj. Gjonaj ishte anëtare e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (PACE) për periudhën 2021–2025, ku në shtator 2023 u zgjodh Raportuese e Përgjithshme për Dhunën ndaj Grave, ndërsa në janar 2024 u zgjodh Zëvendëskryetare e Parë e Komisionit për Barazinë dhe Mosdiskriminimin. Ajo ishte anëtare e COSAC dhe mori pjesë në mekanizma të tjerë parlamentarë të Bashkimit Europian të lidhur me procesin e integritetit të Ballkanit Perëndimor.

Znj. Gjonaj është angazhuar në mësimdhënie në Fakultin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe vijon angazhimin në Fakultet e Drejtësisë në Universitete private. Ajo është autore e disa publikimeve dhe shkrimeve akademike në fushën e shtetit të së drejtës, në të drejtën penale, në të drejtat e njeriut, antikorrupsionin, drejtësia dhe sistemi penitenciar.

Ajo mban titullin Doktor i Shkencave Juridike në fushën e së drejtës penale (2020), pas diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (2003) dhe kryerjes së Masterit dy vjeçar në të drejtën penale (2010). Znj. Gjonaj që nga viti 2004 mban titullin Avokat.

ELSA DHULI

Znj. Elsa Dhuli mban pozicionin e Këshilltares pranë Kabinetit të Kryeministrit prej muajit Prill 2026. Ajo ka kryer një sërë funksionesh, si Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit të Statistikave, prej vitit 2020.

Karriera e saj ka nisur pranë Ministrisë së Mbrojtjes në pozicionin e Përgjegjëses për Punësimin dhe Pagat, duke vijuar më pas prej vitit 1992 pranë Institutit të Statistikave si specialiste, shefe sektori, drejtoreshë drejtorie, koordinatorë cilësie, drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit të Statistikave dhe duke e përmbyllur në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT.

Gjithashtu, znj. Dhuli ka kontribuar si në arenën kombëtare dhe në atë ndërkombëtare në fushën e statistikave. Ajo ka kryer funksionin e Negociatores së Kapitullit 18 “Statistikat”; anëtare e Këshillit Administrativ pranë Sigurimeve Shoqërore; Anëtare e Komitetit për hartimin e

Strategjisë S3; kryetare e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave; anëtare e Këshillit të Statistikave etj.

Në arenën ndërkombëtare, ka mbajtur pozicionin e bashkë-drejtuesses së Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Zhvillim të Kapaciteteve pranë Kombeve të Bashkuara, Departamenti i Statistikave, për Agjendën 2030, për Zhvillim të Qëndrueshëm (UN-HLG-PCCB); nën kryetare e Bordit Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Evropën, të Kombeve të Bashkuara (UNECE), për Konferencën Evropiane të Statistikave; anëtare e bordit Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare të Statistikave (IAOS); anëtare e Institutit Ndërkombëtar të Statistikave (ISI); anëtare e Grupit të Politikave për Bashkëpunim Statistikor të Vendeve në Zhvillim (Eurostat), si dhe ka mbajtur edhe pozicionin e pedagogut të jashtëm në Masterin Shkencor të Statistikave Zyrtare, pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës. Kontribuuese në Forumet Botërore të të Dhënave, Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Znj. Dhuli i ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dega “Ekonomist për Industrinë”, ku ka vijuar më pas me studimet për doktoraturë. Znj. Dhuli mban titullin “Doktor” në shkencat e Statistikës.

Ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit, në fushën e statistikave, leadership, integritet evropian, politikave për zhvillim të qëndrueshëm, në fushën e menaxhimit të projekteve, vlerësimit të performancës etj. Është njohëse dhe folëse e gjuhës angleze.

KEVIN BUFI

Kevin Bufi është Këshilltar i Kryeministrit dhe Koordinator për Bashkëpunimin Rajonal. Në këtë funksion, ai ndjek dhe koordinon çështjet që lidhen me bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor, integritetin në Bashkimin Evropian dhe angazhimin e Shqipërisë në nismat kryesore politike dhe ekonomike evropiane.

Ai ushtron funksionin e EU Sherpa-s të Kryeministrit, duke koordinuar përgatitjen dhe përfaqësimin e Shqipërisë në takimet e Komunitetit Politik Evropian, në samitet ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe në formate të tjera të nivelit të lartë të lidhura me procesin e integritetit evropian. Gjithashtu, shërben si Sherpa i Shqipërisë për Procesin e Berlinit, duke koordinuar pozicionet kombëtare dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e objektivave dhe nismave të këtij procesi.

Në cilësinë e Koordinatorit për Bashkëpunimin Rajonal, Kevin Bufi ndjek angazhimin e Shqipërisë në zbatimin e Tregut të Përbashkët Rajonal dhe nismave që synojnë integritetin gradual të rajonit në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian. Puna e tij përfshin koordinimin e qëndrimeve kombëtare, përgatitjen e takimeve të nivelit të lartë dhe bashkëpunimin me institucionet e Bashkimit Evropian, qeveritë e rajonit dhe organizatat ndërkombëtare.

Kevin Bufi është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ai ka përfunduar programin Advanced Master of Laws në të Drejtën Ndërkombëtare dhe Evropiane të Biznesit në KU Leuven, si dhe programin Advanced LL.M. në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Arbitrazh në Leiden University.

Aktualisht, ai po kryen doktoraturën në Leiden University, me fokus ndërveprimin ndërmjet bashkëpunimit rajonal të Ballkanit Perëndimor dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

ALKIDA THANA

Znj. Alkida Thana shërben si analist në Kabinetin e Kryeministrit prej vitit 2016, në Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ajo vjen nga një eksperiencë 25-vjeçare në fushën e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjes civile dhe sigurisë kombëtare. Në angazhimet e mëparshme, znj. Thana ka shërbyer si Shef Seksioni dhe Analist i Informacionit Kriminal për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin në Policinë e Shtetit, organizimin e punës për shpalljen, ndjekjen, organizimin për kapjen e personave të kërkuar nga drejtësia, si dhe Oficer i Policisë Gjyqësore. Znj. Thana mban diplomën “Bachelor” në Akademinë e Rendit Publik, Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, licencë për Ndërmjetësim dhe zgjidhjen e konflikteve dhe licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit. Znj. Thana ka kryer dhe një sërë kualifikimesh profesionale nga institucione të ndryshme, si EUROPOL, PAMECA, UN, Akademia Diplomatike Shqiptare, ICITAP etj., në fushën e analizës dhe teknikës analitike, përpunimit të informacionit dhe përdorimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit kriminal, ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vlerësimit të kërcënimit nga krimi i organizuar dhe krimet serioze (SOCTA), ndërtimit të institucioneve për anëtarësimin në BE, përafrimin e legjislacionit, dhunën në familje, lidërshipi dhe menaxhimin e krizave etj., si dhe kualifikime në fushën e sigurisë kibernetike.

JONIDA TARAJ

Znj. Jonida Taraj shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës që prej vitit 2022. Në këtë rol, ajo ka ndjekur dhe monitoruar zbatimin e politikave prioritare qeveritare, veçanërisht në fushat e bujqësisë dhe kulturës. Me një eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe privat, znj. Taraj ka mbajtur pozicione drejtuese dhe koordinuese në institucione të rëndësishme të administratës publike. Para angazhimit të saj në Kabinetin e Kryeministrit, ajo shërbeu për pesë vite si Drejtuese e Drejtorisë së Zhvillimit të Shërbimeve pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Gjatë kësaj periudhe, ajo ushtroi njëkohësisht detyrën e Drejtueses së Njesisë për Menaxhimin e Projekteve IPA (SPO) dhe drejtoi ekipin e ADISA Innovation Lab. Gjithashtu, znj. Taraj ka kontribuar si konsulente lokale për ofrimin e shërbimeve në kuadër të projektit ISDA të Bankës Botërore. Karrierën e saj profesionale e nisi në sektorin e arsimit të lartë, ku, krahas angazhimit në mësimdhënie, mbajti pozicionet e Koordinatorës së Institutit Barleti për Kërkim dhe Zhvillim dhe Menaxheres së Qendrës së Karrierës pranë Universitetit “Marin Barleti”.

Znj. Taraj është diplomuar në Universitetin e Bergamos, Itali, ku ka përfunduar studimet “Master i Shkencave” në Ekonomi, Inovacion dhe Organizim të Bizneseve në Tregun Global, si dhe studimet e ciklit të parë “Bachelor” në Ekonomik dhe Biznes.

AIDA HASMETA

Znj. Aida Hasmeta shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe, znj. Hasmeta ka ndjekur zbatimin e politikave kryesore në fushën e shëndetësisë, çështjeve sociale, administratës publike, si edhe shërbimeve publike dhe digjitalizimin.

Më herët, ka shërbyer si koordinator pranë kësaj njësie për çështjet e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës. Znj. Hasmeta vjen nga një eksperiencë e gjatë në monitorimin dhe hartimin e politikave, si edhe të dokumenteve strategjike.

Ajo ka nisur karrierën e saj në Ministrinë e Shëndetësisë, ku ka shërbyer si specialiste e monitorimit dhe vlerësimit të informacionit shëndetësor dhe është angazhuar në grupet e punës për monitorimin e programeve të qeverisë, hartimin e strategjisë së shëndetësisë, planit të veprimit të promocionit shëndetësor, koordinimin sektorial dhe ndërsektorial për konsultimin publik, monitorimin e fëmijëve në rrezik braktisjeje shkolle, zbatimin e akademisë së shëndetit në shkolla etj.

Më parë, është angazhuar me organizata joqeveritare me projekte në çështjet sociale dhe të arsimit. Znj. Hasmeta është diplomuar në Universitetin e Mjekësisë Tiranë për “Mjekësi të përgjithshme”.

Gjithashtu, ajo ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e politikave shëndetësore të fokusuara në mbulimin shëndetësor universal, të ofruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik Zvicëran.

ARDIT DRENOVA

Z. Ardit Drenova shërben si Analist pranë Kabinetit të Kryeministrit, ku koordinon çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik, si dhe me monitorimin e zbatimit të prioritetëve qeveritare.

Z. Drenova ka një eksperiencë mbi 15-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë, ka shërbyer si Auditues i Lartë pranë KPMG Shqipëri, ku ka udhëhequr angazhime auditimi për kompani vendase dhe ndërkombëtare, duke siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe duke ofruar ekspertizë në analizën financiare, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e riskut.

Z. Drenova ka përfunduar studimet universitare në nivelin “Bachelor” pranë Universitetit Amerikan në Bullgari, në fushën e Ekonomisë, me profile shtesë në Shkenca Kompjuterike dhe Matematikë.

UJEZA BARDHI

Znj. Ujeza Bardhi shërben si Analiste e Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit. Ajo ka mbi 5 vite përvojë profesionale në marrëdhënie ndërkombëtare, politika publike, diplomaci dhe koordinim strategjik pranë strukturave të nivelit të lartë politik dhe institucional. Znj. Bardhi mban diplomën “Master i Shkencave” në Marrëdhënie Ndërkombëtare, me profil në Qeverisje dhe të Drejta, nga Universiteti The New School në New York (2020), si dhe diplomën “Bachelor” në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i New York-ut në Tiranë (2017).

Në rolin e saj pranë Kabinetit të Kryeministrit, ajo kontribuon në monitorimin e prioritetëve strategjike qeveritare, reformave institucionale dhe proceseve të integritetit evropian përmes përgatitjes së analizave, dokumenteve strategjike dhe materialeve mbështetëse për procesin e vendimmarrjes, si dhe koordinimit ndërinstitucional. Më herët, ka shërbyer si Ndihmëse e Kryeministrit, ku ka qenë përgjegjëse për koordinimin dhe mbarëvajtjen e agjendës së Kryeministrit, si dhe ka mbështetur organizimin e vizitave shtetërore, samiteve dhe angazhimeve të nivelit të lartë, duke siguruar zbatimin e standardeve të protokollit diplomatik dhe koordinimin me ambasada të huaja, organizata ndërkombëtare dhe partnerë institucionalë.

Znj. Bardhi ka kryer praktikën profesionale pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OCHA) në New York (2019–2020), ku është angazhuar në komunikimin strategjik dhe përgatitjen e materialeve për promovimin e financimit parandalues në raste krizash humanitare, në mbështetje të angazhimit me donatorë dhe partnerë institucionalë. Më herët, ka kryer praktika profesionale në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Bashkinë e Tiranës (2018) dhe në Departamentin e Çështjeve Konsullore të Ambasadës së Kosovës në Shqipëri (2016).

Gjithashtu, ajo bashkëpunon periodikisht me European Fund for the Balkans, një nismë që mbështet transformimin demokratik dhe integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor, duke kontribuar në përkthimin dhe përshtatjen në gjuhët shqip dhe anglisht të materialeve mbi bashkëpunimin dhe dialogun rajonal. Znj. Bardhi ka njohuri të gjuhëve angleze, italiane dhe spanjolle.

INA MEMISHAHI

Ina Memishahi ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Histori-Filologjisë, në degën Gjeografi, ku mban titullin Specialist i Gjeografisë. Më tej, ka ndjekur studimet Master në Administrim Publik. Gjithashtu, ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh profesionale në fushat e mjedisit, statistikave dhe hartimit të standardeve profesionale pedagogjike.

Znj. Memishahi zotëron një përvojë të gjerë profesionale në administratën publike dhe sektorin privat. Gjatë karrierës së saj, ka mbajtur detyra të ndryshme, ndër të cilat: Asistente Noteri, Sekretare Ndihmëse, Sekretare e Parë, Kryesekretare, Asistente Dekani, si dhe pozicione ndihmëse dhe koordinuese në organizata jofitimprurëse dhe institucione të arsimit të lartë.

Në Kryeministri, ka ushtruar funksione të rëndësishme administrative dhe mbështetëse, përfshirë ato të Sekretares së Kryeministrit, Asistentes së Drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit dhe Ndhmësës së Kryeministrit. Aktualisht, ajo mban detyrën e Analistes së Kryeministrit. Angazhimi i saj profesional është i përqendruar në administrimin publik, koordinimin institucional dhe mbështetjen e proceseve të qeverisjes efektive. Ina Memishahi është pjesë e Kabinetit të Kryeministrit që prej vitit 2013.

HENRI HAXHIA

Henri Haxhia ushtron detyrën e Analistit pranë Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rol, ai angazhohet në analizën e çështjeve ekonomike, monitorimin e treguesve makroekonomikë, përgatitjen e materialeve analitike dhe strategjike, si dhe mbështetjen e proceseve të vendimmarrjes.

Më parë, ka ushtruar funksione në sektorin publik dhe privat, duke fituar përvojë në koordinimin institucional, bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, marrëdhëniet me palët e interesit dhe menaxhimin e projekteve.

Është diplomuar në Financë dhe zotëron një Master në Administrim Biznesi (MBA). Gjithashtu, ka ndjekur programe të specializuara në fushat e negociimit, menaxhimit të krizave, marrëdhënieve me palët e interesit dhe menaxhimit të rrezikut.

ENIO OHRI

Z. Enio Ohri shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit. Ai vjen nga një eksperiencë pune në organizatat e shoqërisë civile, ku ka shërbyer si koordinator i projekteve. Më parë, z. Ohri ka shërbyer pranë Kabinetit të Kryeministrit si ndihmës.

Z. Enio Ohri mban diplomat “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” për administrim biznes nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.

NERINA ILJAZAJ

Nerina Iljazaj shërben si Sekretare e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

E diplomuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane pranë Universitetit të Firences, ajo ka një eksperiencë të gjerë në administratën publike, koordinimin institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përvoja e saj profesionale përfshin role në Kabinetin e Kryeministrit dhe në projekte rajonale të bashkëpunimit, duke kontribuar në menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve strategjike. Znj. Iljazaj zotëron njohuri të avancuara të gjuhës italiane dhe angleze.

MARSEL PRECI

Specialist i teknologjisë së informacionit me mbi 20 vjet përvojë në sektorin publik dhe privat në Shqipëri, i specializuar në menaxhim projektesh IT, infrastrukturë rrjeti dhe zhvillim web full-stack.

Kabineti i Kryeministrit (2015–aktualisht): Asistent i Kryeministrit dhe Këshilltar për Projektet e TIK-ut. Mbështetje IT për Kryeministrin dhe anëtarët e tjerë të kabinetit.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (2013–2015): CTO i Datacenter-it të Qeverisë Shqiptare. Përgjegjës për ISP-në kombëtare të AKSHI-t, GOVNET dhe portalin e shërbimeve publike e-Albania.al. Përgjegjës për veprimtarinë e përditshme të datacenter-it dhe për kërkesat teknike të të gjitha projekteve qeveritare IT të dala në tender.

Aktivitet privat (2010): Freelancer dhe zhvillues full-stack për sisteme web, aplikacione dhe Sisteme. Menaxher projektesh IT.

Bashkia e Tiranës (2009–2010): Përgjegjës i sektorit për hartim dhe zbatim politikash për ciklin e zhvillimit të software-it; planifikim dhe zbatim ndryshimesh në infrastrukturën IT; parashikim i nevojave të ardhshme të rrjetit; menaxhim i help desk-ut, i blerjeve dhe buxhetit IT; administrim teknik i faqes së Bashkisë, domain-it dhe mail server-it.

Bashkia e Tiranës (2006–2008): Specialist IT – mbështetje IT dhe helpdesk.

Arsimi: Master i Shkencave në Teknologji Informacioni, Universiteti Politeknik i Tiranës (2006–2011); Bachelor në Teknologji Informacioni, Universiteti Politeknik i Tiranës (2003–2006).

ISEI DAKOLI

Znj. Isei Dakoli shërben si ndihmës i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës që prej vitit 2022.

Znj. Dakoli ka përfunduar studimet e nivelit Master në Universitetin e Gjenevës, në Zvicër, në programin “Master of Science in Statistics”. Ajo mban gjithashtu një diplomë Bachelor në Ekonomi nga i njëjti universitet, me specializim në Statistikë.

MARIELA KATRO

Zj. Mariela Katro shërben si Ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit, Zyra e Protokollit të Kryeministrit.

Më parë, ka shërbyer si redaktore gjuhësore pranë gazetës “Panorama”, redaktore pranë kompanisë “Unison Agency”, si dhe redaktore pranë shtëpisë botuese “Onufri”.

Zj. Mariela Katro mban diplomën Post Master në Programin e Studimit Marrëdhënie Ndërkombëtare pranë “Albanian University”, si dhe diplomën për Gjuhë-Letërsi, specialiteti Gjuhësi, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Ka mbaruar Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, dega anglisht. Po ashtu, disponon certifikatën e INIMA-s dhe Dëshminë e Mbrojtjes së Gjuhës Angleze pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Gjithashtu, ka marrë pjesë në trajnime në studimet politike, historike, në fushën juridike etj., pranë Akademisë Profesionale “Elita”.

GREJSI BIXHI

Zj. Grejsi Bixhi shërben si Ndhimëse pranë Kabinetit të Kryeministrit, Zyra e Protokollit të Kryeministrit.

Zj. Bixhi ka kryer studimet e larta në fushën e Informatikës dhe është specializuar në Teknologji Informacioni. Zj. Bixhi është gjithashtu anëtare e Këshillit Bashkiak Tiranë.

Angazhimi i saj ka nisur që në moshën 16-vjeçare përmes nismave të shumta vullnetare në komunitet.

Përveç rolit të saj në Këshill, Zj. Bixhi ka fituar përvojë në administratën publike (përfshirë INSTAT dhe strukturat mbështetëse të Kabinetit të Kryeministrit).

MERITA SALIAJ

Znj. Merita Saliaj mban pozicionin e Ndhimëses së Kryeministrit në Kabinetin e Kryeministrit. Ajo ka një përvojë disa vjeçare pune në Kryeministri.

Znj. Saliaj ka përfunduar studimet e larta për Drejtësi, me specializim në të drejtën civile dhe tregtare.

Gjithashtu, ajo ka kryer një sërë trajnimesh dhe zotëron kualifikime në fushën e së drejtës evropiane, sigurisë kombëtare dhe antikorrupsionit.

SKËNDER DUKA

Zoti Skënder Duka shërben si Ndhimës në Kabinetin e Kryeministrit. Në këtë detyrë, ai vjen nga një përvojë disavjeçare në Shoqërinë Civile si bashkëpunëtor dhe koordinator projekti. Më parë, ai ka shërbyer në dy legjislatura si Zëdhënës i Shtypit i Kryetarit të Kuvendit. Në këtë angazhim, zoti Duka vinte pas një pune mbi dy dekada në shtypin periodik për të mbërritur tek emërimi i parë, ai i Kryeredaktorit të gazetës “Studenti”, organ i rinisë universitare. Ai ka punuar edhe disa vite si pedagog i jashtëm i lëndës së Estetikës në Universitetin e Tiranës.

Ai ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike të Universitetit të Tiranës, në degën e Gazetarisë. Më parë, ai është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të UT-së.

Njëherësh, gjatë viteve të tij të punës, zoti Duka është kualifikuar në tematika të tilla si: “Media dhe Transparenca” – Fondacioni “Friedrich Ebert”; “Marrëdhëniet me Publikun dhe Media” – kualifikim nga Senati Amerikan; “Praktikat Parlamentare dhe Transparenca në Media” – Zagreb, East West Program; “Media dhe Qeverisja Elektronike” – OKB, New York; “Media dhe informimi publik”; “E drejta e Publikut për Informacion dhe Administrata Publike”. Ai ka botuar librin me ese “Dialog i munguar” dhe është bashkëpunëtor në botimin e serisë: “Monitori shqiptar i Medias”. Zotëron gjuhët anglisht dhe frëngjisht.

BJORN KAMBERI

Bjorn Kamberi shërben si Ndihmës i Kryeministrit që prej vitit 2024. Ai është i diplomuar në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, me fokus në sigurinë ndërkombëtare, organizatat shumëpalëshe dhe diplomacinë, duke ndjekur studimet në Shqipëri, Texas dhe New Jersey, SHBA.

Më parë, ai ka qenë pjesë e programit Lead Albania, ka shërbyer si konsulent për marrëdhëniet ndërkombëtare në sektorin e energjisë në Shqipëri, si dhe ka kontribuar në kapacitete akademike dhe analitike pranë një sërë organizatash studimore në Shqipëri dhe Shtetet e Bashkuara. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe analizash të fokusuara në çështjet e sigurisë, integritetit evropian dhe gjeostrategjisë. Gjithashtu, është autor i tre librave, ku ndërthur kërkimin historik me letërsinë artistike.

MIRA RAKACOLLI – KAPISYZI

Mira Rakacolli – Kapisyzi është mjekë neurologe, mban titullin akademik Profesor dhe është eksperte e politikave shëndetësore me një karrierë mbi katër dekada në shërbimin klinik, arsimin universitar dhe administratën publike.

Diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1983 dhe e specializuar në Neurologji në vitin 1987, ka ushtruar profesionin e mjekes neurologe pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (1986–2017). Nga viti 1991 është pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë; në vitin 1997 ka fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave Mjekësore” dhe në vitin 2013 titullin akademik “Profesor”.

Prof. Rakacolli ka kryer specializime profesionale në Itali, Francë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo ka mbajtur detyrën e Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë (2014–2016), atë të Drejtueses së Shërbimit Neurovaskular në QSUT dhe Kryetares së Komitetit të Etikës pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Në periudhën 2017–2025 ka mbajtur detyrën e Zëvendësministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke kontribuar në mënyrë aktive në hartimin dhe zbatimin e reformave kryesore të sektorit shëndetësor, përfshirë forcimin e kujdesit shëndetësor parësor, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë, Planit Kombëtar Spitalor dhe reformës spitalore, si dhe zhvillimin e politikave në fushën e barnave, shëndetit publik dhe mbrojtjes

sociale. Gjatë kësaj periudhe ka qenë e përfshirë në proceset e transformimit të sistemit shëndetësor dhe në koordinimin e programeve kombëtare të zhvillimit të tij.

Prof. Rakacolli ka qenë gjithashtu anëtarë e Këshillit Bashkiak të Tiranës (2019–2023).

Ajo është Presidente e Shoqatës Shqiptare të Neurologjisë dhe anëtarë e Akademisë Amerikane të Neurologjisë, Akademisë Europiane të Neurologjisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Çrregullimeve të Lëvizjes.

Veprimtaria e saj shkencore përfshin autorësinë e teksteve universitare dhe monografive, mbi 150 prezantime në konferenca dhe kongrese shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe një numër të konsiderueshëm publikimesh shkencore në revista shqiptare dhe ndërkombëtare.